



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

VENDIM

Nr. 2, datë 11.01.2022

PËR

**NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT NR.1, DATË 07.01.2022 TË KËSHILLIT
TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 113 e 117 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 99 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, si dhe në informacionin e dërguar nga gjyqtarja Lutfije Celami dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me email-et e datës 10.01.2022, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Ndryshimin e pikës 1, nëndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë”, faqja e dytë paragrafi i parë i Vendimit Nr.1, datë 07.01.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Pëllumb Zaimi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 79/dh, 22, 25, 278/1 të Kodit Penal”, (krahas gjyqtareve Adelajda Gjuzi (relatore) dhe Entela Gjoni, të caktuara më parë në gjykimin e kësaj çështjeje sipas vendimit nr.1, datë 07.01.2022 të KLGJ).

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit përkatës të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR